V E N D I M
Nr.37, datë 23.1.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.514, DATË 31.10.1994 "PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË PËRFAQËSUESIT TË AUTORIZUAR TË PATENTAVE"

Mbështetur në ligjin nr. 7819, datë 27.4.1994 "Për pronësinë industriale", me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 31.10.1994 "Për ushtrimin e profesionit të përfaqësuesit të autorizuar të patentave", fjalët "... dhe personat fizikë të punësuar e të autorizuar nga personat juridikë", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi